



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2021-2022

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hap testin dhe mos fillo t'i zgjidhës detyrat para se të japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore.

Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar në zgjidhjen e detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon ta përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

→ është e pasaktë

→ është e palexueshme dhe nuk është e qartë

→ është e shkruar me laps grafit/të thjeshtë

→ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

FAQJA E ZBRAZËT

Në bazë të tekstit Si lindi kubi i Rubikut? Përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

SI LINDI KUBI I RUBIKUT?

Kubi i Rubikut, i njohur gjithashtu si kubi magjik ose hungarez, është një lojë ose enigmë mekanike e kombinimit 3D e shpikur në vitin 1974 nga profesori hungarez i arkitekturës Erno Rubik.


Lëvizja e pjesëve të kubit, pa u ndarë, është vërtet magjike. Kubi përbëhet nga 54 katrorë plastikë më të vegjël që rrotullohen rreth një bërthame qendrore dhe secila nga gjashtë anët që përbëjnë kubin në një formë të zgjidhur është me ngjyrë të ndryshme.

Në mesin e viteve 1970, Rubik mësoi dizajn në Akademinë e Arteve të Aplikuara në Budapest dhe u përpoq të gjente një mënyrë për t'ua paraqitur lëvizjen 3D studentëve të tij. Ai e shikoi Danubin për një kohë të gjatë dhe mendoi për lëvizjen e ujit rreth zhavorrit dhe ky fenomen shërbeu si frymëzim për mekanizmin lëvizës të kubit.

Rubik tha një herë se ai përdori dru, shirita gome dhe kapëse për të bërë prototipe për eksperimentet. Ai kishte nevojë për një lloj kodimi që rrotullimi i kubit të kishte kuptim. Në fund, ai përdori zgjidhjen më të thjeshtë - ngjyrat bazë. Ai vendosi ngjitesit në kubin e përfunduar dhe më pas u bë i vetëdijshëm se mbante në dorë një enigmë të vërtetë. Megjithatë, ai nuk ishte i sigurt se mund ta zgjidhte - iu deshën disa javë për të kombinuar ngjyrat.

Kubi i Rubikut përbëhet nga gjashtë anë me nëntë katrorë në të bardhë, të kuqe, portokalli, blu, të verdhë dhe jeshile dhe duhet të vendoset në mënyrë të tillë që secila anë të jetë njëngjyreshe. Për të filluar montimin e një kubi Rubik, duhet të dini se si quhen anët e tij. E rregulluar fare thjesht, ana e djathtë quhet Riht ose R, ana e majtë Left ose L, ana e mesme quhet Middle ose M, ana e pasme është Back ose B, ana e përparme është Front ose F, ana e sipërme është Up ose U, dhe ana e poshtme është Down ose D.

Nëse nuk e keni marrë një Kub Rubik klasik 3x3 që kur keni qenë fëmijë dhe dëshironi ta bashkoni atë, do t'ju duhet të kaloni nëpër faza të ndryshme për ta bërë këtë. Kubi mund të bashkohet në shumë mënyra, dhe më të njohurat sot sigurisht janë metoda fillestare e grumbullimit dhe metoda e Friedrihit. Në të dyja këto teknika, kryqi vendoset fillimisht në njërën anë, pastaj mbushet ajo anë, më pas vendoset shtresa tjetër dhe në fund orientohet ana e pasme.



(përgatitur sipas tekstit të marrë nga: https://m.cdm.me/argëtuese/interesante/si_lindi_kubi_i_rubikut-2/, 17 tetor 2021)

1. Shkruaj si lindi kubi i Rubikut.

1 pikë

2. Nëse pohimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë, rretho P.

1. Profesor Rubiku arriti ta bashkonte kubin në vetëm pak ditë. S P
2. Për të montuar siç duhet kubin, është e nevojshme të ndani pjesët e tij. S P
3. Ngjitëset me ngjyra të Rubikut u ngjitën në kubin e përfunduar. S P

1 pikë

3. Cili është qëllimi i lojës me kubin e Rubikut?

1 pikë

4. Kubi mund të montohet saktë vetëm në bazë të metodës së Fridrihit.

PO JO

Nëse pohimi është i saktë, rretho PO, dhe nëse jo, rrethoni JO. Shpjego zgjedhjen tënde.

1 pikë

5. A) Çfarë duhet të dini për të bashkuar një kub të Rubikut?

1 pikë

B) Kushtoji vëmendje vizatimit të kubit të Rubikut. Çfarë informacioni jepet në tekst (paragrafi 5) e që mungon në vizatim?

1 pikë

6. Cili është dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe?

1. *Fjalori i Arnold Fon Harfit*
2. *Formula e Pagëzimit*
3. *Meshari i Gjon Buzukut*

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

Lexo vargjet dhe pastaj përgjigju në pyetjet 7, 8 dhe 9.

*Pava ndër qiellin e vrrinit dikur
tue kalue shumë re
dhe lumenjt e turbullt tue bajtun
gur e landë.
Tue hy në të shtatën vjetë
ujkun e pava n'ikje me bisht ndër kambë
e me veshë të ngritun currek përpjetë.
Shkova me njerzit e mij
shtigjev të malit
dhe pata u e et.
Ndigjova ortiqet e bubullimët e motit
e fjalën , 'mos u tremb' tim et.*

7. Cilës gjini letrare i përkasin vargjet e veçuara?

1 pikë	
--------	--

8. A) Poezia është shkruar në dialektin e:

1. jugut
2. veriut

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

B) Argumentoje përgjigjen nën A me të paktën dy fjalë që e vërtetojnë përgjigjen e saktë.

1 pikë

9. A) Çfarë kujton poeti nga jeta e tij?

1 pikë

B) Ilustro me vargje nga poezia periudhën e jetës që mban mend poeti.

1 pikë

10. Në vargun O mbret i pafat e mjeran! Ç' pjesë e ligjëratës janë dy fjalët e nënvizuara? Ç'figurë letrare formojnë ato?

Pjesë e ligjëratës: _____

Figura letrare: _____

2 pikë

11. Rretho përdorimin e gabuar të nyjës së përparme.

1. Poezia e një nxënëseje të shkollës sonë.
2. Piktura e një nxënësi të shkollës sonë.
3. Krijimet e të kaluarës së hidhur.
4. Krijimet e një të kaluare.

1 pikë

Lexo me kujdes tekstin pastaj përgjigju në pyetjet 12, 13 dhe 14.

*Dheu bleron e gjallërojnë fusha, male, brigje, maja
Edhe gjithë gjë e gjallë ndjen në zemër një dëshirë,
Një gas t'ëmbël e të shumë, o sa bukur e sa mirë!
Pelën e ndjek mēz'i bukur, lopës i vete viçi pas,
Dallëndyshja punëtore bën folenë me të math gas;
Ogjiç i kënd përpara, i bije tufës në ballë.
Me zemër të çelur shumë vetë si trimi me pallë;
Zogjtë zënë këng' e valle po kërcëjnë e këndojnë
E nëpër dega me lule si engjëllit fluturojnë.*

12. Në bazë të fragmentit shkruaj titullin e veprës dhe autorin e saj.

_____ (vepra)

_____ (autori)

2 pikë

13. Fjalëve të veçuara caktoju klasën.

kërcejnë _____

bukur _____

dallëndyshe _____

një _____

2 pikë

14. Kjo vepër është shkruar ne vargun:

1. 8 - rrokësh

2. 11 - rrokësh

3. 16 - rrokësh

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

15. A) Përcakto klasën e fjalës së nënvizuar në fjalinë e mëposhtme.

Më shtrëngoi **fort** pas vetes. _____

1 pikë

B) Shkruaj përbërësit e fjalës udhëtarët.

1. rrënja: _____

2. prapashtesa: _____

3. mbaresa: _____

2 pikë

16. Plotëso tabelën sikurse është filluar.

VEPRA	EMRI DHE MBIEMRI I AUTORIT	PERSONAZHI KRYESOR
<i>Andrra e jetës</i>	Ndre Mjeda	Trina
<i>Tregtar flamujsh</i>		
		Tursun Pasha
	Ernest Heminguej	

3 pikë

17. Titullin e veprës lidhe me llojin letrar. Ki kujdes, një lloj letrar është i tepërt.

Bagëti dhe bujqësi
Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e zotit
Romeo dhe Zhulieta

këngë epike
poemë lirike
tregim
tragjedi

2 pikë

18. Shkruaji saktë shkurtesat.

e të tjera _____
për shembull _____
era ere _____

2 pikë

19. Nënvizo fjalën e shkruar saktë.

A) socijologjija socjologjia sociologjia

1 pikë

B) sy patrembur sypatrembur sy pa trembur

1 pikë

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2022